



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:121831

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05844262

C.nr.1537/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Driton Ahmeti si dhe bashkëpunëtorin profesional F.H., në çështjen juridike të iniciuar me padinë e paditësit S.S. nga fshati M., Komuna Shtime, të cilin me autorizim e përfaqëson Taulant Ismajli avokat nga Prishtina, Rr."Selim Kraja" nr.3, Hajvali, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokatura Shtetërore me seli në ish-Pallatin e Rilindjes, Prishtinë, për shkak të kompensimit të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, jashtë seancës më dt.21.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- për shkak të pa dëgjueshmërisë / mosbindjes -

APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit S.S. nga fshati M., Komuna Shtime, si e bazuar.

DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës – Policia e Kosovës, që paditësit S.S., në emër të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, t'ia paguaj shumën e tërësishme prej **3,083.23 €** (tremijë e tetëdhjetë e tre euro e njëzetë e tre cent) me kamatë ligjore prej 8% duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 144.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m i

Paditësi S.S. përmes të autorizuarit të tij më dt.16.06.2021 ka paraqitur padi pranë kësaj gjykate, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, të cilën padi më vonë e ka precizuar dhe ka kërkuar shpërblimin e pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Për të mbështetur pretendimet e saj në padi, paditësi si prova ka sjellë këto dokumente: vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, si dhe listën e pagave për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, si dhe vlerësimet e punës në emër të S.S..

Gjykata, më dt.27.08.2021 të paditurës, i'a ka dorëzuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padi, por e paditura, ndonëse i ka pranuar shkresat me rregull (provë: fletëkthesa e nënshkruar nga e paditura me datë 27.08.2021) brenda afatit të caktuar ligjor, e as deri në këto momente, nuk ka ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e saj nëse e kundërshton apo jo kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa gjykata nga provat e çështjes, ka gjetur se themelësia e kërkesëpadiisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësi.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 të LPK-së, që përjashton mundësinë për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata, konform nenit 150 të LPK-së, lidhur me nenin 29 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 dhe nenin 30 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Polici, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës Gjykata vendosi konform nenit 452 par.1 të LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 144.00 € dhe atë si në vijim: për taksë gjyqësore shumë prej 40.00 € si dhe për përpilim të padisë shumë prej 104.00 €, konform tarifave të OAK-së.

Gjykata e ka obliguar paditësin që paraprakisht të paguaj taksën gjyqësore shtesë për paraqitje të padisë në shumë prej 10.00 €, konform nenit 12.1 të UA nr.01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.1537/21, më datë 21.06.2024

Gjyqtari,
Driton Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.